
AKT- THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"4M Studio " Shpk

Neni 1
Emërtimi i Shoqërisë

1. Ne Tirane ne daten 01 Shtator 2025 (*Dy mije e njezete e pese*) krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**" i ndryshuar, te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit" te ndryshuar ,si dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe dispozitat e Statutit te shoqerise qe i bashkengjiten ketij Akti Themelimi, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin: "**4M Studio**" shpk.
2. Kjo Shoqëri është Person Juridik në përputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe aktiviteti i saj rregullohet duke u bazuar ne Statutin dhe në këtë akt themelimi si dy akte bazë të kësaj Shoqerie.

Neni 2
Selia i Shoqërisë

1. Selia kesaj Shoqerie do te jete ne adresen: **Rruga Liria; Zona kadastrale 1649, Numri i Pasurise 41/14; 1054; Valias, Tiranë, Shqipëri**, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj dhe per te hapur dege dhe filiale te tjera ne Republiken e Shqiperise si dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
2. Asambleja Pergjithshme e Shoqerise mund te krijoje, ndryshoje apo mbylle seli sekondare, agjensi dhe perfaqesi kudo qe e quan te nevojshme edhe jashte shtetit.

Neni 3
Kohëzgjatja i Shoqërisë



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, por ajo mund të shperbehet me miratim të Asamblesë së Jashtëzakonshme sipas rasteve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë me miratim të Ortakëve të shoqërisë (shperberja dhe likuidimi).

Neni 4 **Objekti i Shoqërisë**

1. Objekti kryesor i shoqërisë do të jetë:

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet në fushën e projektimit, zbatimit, supervizimit, kolaudit dhe konsulencës në arkitekturë, urbanistikë, ndërtim, mekanikë, hidraulikë, energjetikë, elektrike, rrugë dhe hekurudha, për të gjitha llojet e objekteve civile, industriale dhe të posaçme, përfshirë ato të mbrojtjes, të policisë së shtetit dhe të shërbimit informativ. Ajo do të zhvillojë gjithashtu konsulencë dhe studime në fushën gjeologjike, topografike, minerare, të hidrokarbureve, të energjive të rinovueshme, të trajtimit të ujit të pijshëm, të mbetjeve të ngurta dhe të ndotura, si dhe të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Shoqëria do të ofrojë konsulencë për kolaudit dhe kontroll të automjeteve dhe pajisjeve të tyre, si edhe shërbime në fushën e eficiencës energjetike, auditimit dhe menaxhimit të energjisë.

Objekti i veprimtarisë përfshin importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme, pjesëve të këmbimit për automjete, makinerive dhe pajisjeve industriale, bujqësore, blegtorale dhe teknologjike të çdo lloji, si edhe ngritjen e laboratoreve dhe impianteve të ndryshme inxhinierike. Përfshihet importi, eksporti dhe tregtimi i vajrave lubrifikantë, i pajisjeve dhe sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit, si edhe i pajisjeve elektro-shtëpiake. Gjithashtu, shoqëria do të zhvillojë shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje për automjete të çdo kapaciteti dhe pajisje për servisimin e tyre.

Shoqëria do të merret me mirëmbajtjen e sistemeve dhe impianteve teknologjike, mekanike dhe elektrike për përdorim civil, mjekësor, ushtarak dhe industrial, përfshirë sistemet hidraulike, ujesjellësit, sistemet e ventilimit, hidrosanitarët dhe shkarkimet, mbrojtjen ndaj zjarrit, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit, prodhimin dhe shpërndarjen e ajrit dhe gazrave të ndryshëm teknikë për përdorim spitalor ose industrial. Ajo do të kryejë punime dhe rikonstruksione të ndryshme ndërtimore, instalime të sistemeve elektrike dhe elektronike, automatizimi dhe transmetimi të të dhënave, sistemeve të ndriçimit, vaditjes së fushave sportive, stadumeve, pishinave, saunave dhe hidromasazheve.

Shoqëria do të kryejë transport mallrash brenda dhe jashtë vendit, si për nevojat e veta ashtu edhe për palë të treta. Përfshihet edhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e studimit të tregut, asistencës për kërkim fondesh, investimesh dhe kredish financiare, hartimit të planeve të biznesit dhe menaxhimit të projekteve gjatë zhvillimit dhe në etapat pasuese.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të ligjshme të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Aktivitetet që kërkojnë leje, licenca apo autorizime përkatëse do të ushtrohen vetëm pasi të jenë marrë këto leje, licenca apo autorizime.

Neni 5 **Kapitali themeltar**



1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë.
2. Ortaku themelues është:

1. Z. Shpresim Neçi, atësia Kadri, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës, Shqipëri më datë 29.06.1994, banues në adresën "Rruga Migjeni; Nderresa 37, Hyrja 1, Kashar, Yzberisht; 1050, Tiranë" mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J406290330, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë..

1. Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga ortaku i vetëm i shoqërisë pas themelimit të Shoqërisë.
2. Përgjegjësia e Ortakut të vetëm të Shoqërisë shtrihet deri në shumën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 6

Organet e Shoqërisë

1. Organet e shoqërisë janë: Asambleja e Ortakeve dhe Administratori.
2. Asambleja e Ortakeve është organi më i lartë i shoqërisë. Nepermjet këtij emërohet administratori i shoqërisë. Administratori i Shoqërisë "4M Studio " Sh.p.k. , emërohet për një mandat deri pesë vjet 01.09.2025-31.08.2030 me të drejta ripërteritje, Z. Shpresim Neçi, i biri i Kadriut.
3. Ortaket themelues dhe administratori ushtrojnë të gjitha kompetencat, të drejtat dhe detyrimet, të cilat parashikohen nga statuti i Shoqërisë, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, për organizimin , drejtimin dhe për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Neni 7

Viti Financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht viti I parë financiar i cili fillon kur nise veprimtaria e shoqërisë do të mbyllet më 31 Dhjetor. Shoqëria e fillon aktivitetin në momentin e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 8

Dispozita të tjera

1. Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me anë të kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen me kontratën e punës, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës. Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kësaj Shoqërie mbrohen nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.
2. Për ruajtjen dhe sigurimin e pasurive të saj të luajtshme dhe të paluajtshme kjo Shoqëri mund t'u drejtohet Shoqërive të Sigurimit në qendër dhe deget e tyre, që Asambleja e Ortakeve do ta vlerësojë për të siguruar aktivitetin e Shoqërisë.
3. Dispozita me të hollësishme janë parashtruar në STATUTIN e kësaj Shoqërie e cila shpreh vullnetin e lirë të themeluesve.



Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ,do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërmjet palëve të interesuara, në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës Kompetente.

Neni 10
Harti i Akt-Themelimit të Shoqërise

Akt-Themelimi i Shoqërise me përgjegjësi të kufizuar " 4M Studio " Shpk u hartua në Tiranë, më 01.09.2025.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"4M Studio" Sh.p.k.

Ortaku Themelues:

Z. Shpresim NEÇI

(emër mbiemër/nënshkrimi)

Shpresim Neçi